

VENDIM “NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Hilmi Dakli, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Hajredin Fuga, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Alfred Karamuço, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Kristofor Peçi, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Kujtim Puto, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Sokol Sadushi, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci, Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Me sekretare Drita Filto, më datë 26.10.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr. 57, Akti që i përket:

KËRKUESE: DHOMA E TREGTISË DHE INDUSTRIË Vlorë, e përfaqësuar nga kryetari Bardhyl Nasto dhe Avokat Ilirjan Deshalla, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

OBJEKTI: Shpallja si i pajtueshëm me Kushtetutën i Vendimit nr. 129, datë 18.03.1999 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe kushtet e dhënies së lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, si dhe pezullimin e zbatimit të tij.

Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi, duke parashtuar këto shkaqe:

1. Në kundërshtim me nenet 100/4 e 117/1-rë të Kushtetutës ky vendim që thuhet se është nxjerrë me propozim të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në Fletoren Zyrtare është botuar pa firmën e tij.

2. Gjithashtu vendimi në fjalë në kundërshtim me nenin 118/2 të Kushtetutës, nuk bazohet në parimet e Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 dhe ka dalë jashtë këtyre parimeve.

3. Duke vendosur kushte për kapitalin financiar dhe kapacitetin e depozitave për rezervën e naftës e të gazit, të cilat janë të papërballueshme nga subjektet tregtare, ky akt, në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës, ka bërë kufizime të lirisë së tyre në ushtrimin e kësaj veprimtarie ekonomike, kufizime këto që mund të vendosen vetëm me ligj.

4. Zbatimi i këtij vendimi do të sjellë monopolizimin e kësaj veprimtarie në dorën e dy ose tre subjekteve të fuqishëm dhe falimentimin e subjekteve të tjera, duke cënuar kështu parimet e ekonomisë së tregut të lirë dhe të ligjit për konkurrencën.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të palës kërkuese dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Shkaqet që ka parashtuar Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Vlorë për pajtueshmëri me Kushtetutën të Vendimit nr. 129, datë 18.03.1999 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, janë të pabazuara. Për rrjedhojë kërkesa e saj për shfuqizimin e këtij vendimi si antikushtetues, nuk duhet pranuar.

Fakti, se ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare pa kundërfirmën e Ministrit propozues, nuk do të thotë se një veprim i tillë vjen në kundërshtim me pikën 4 të nenit 100 të Kushtetutës. Respektimi i kësaj kërkeje të parashikuar në këtë dispozitë kërkohet vetëm për efekt të vlefshmërisë së akteve që nxjerr Këshilli i Ministrave dhe ka të bëjë jo vetëm me fazën e publikimit, po me atë të miratimit të tyre.

Në këtë fazë, siç rezultoi gjatë gjykimit, ky organ, për rastin konkret, e ka zbatuar këtë rregull kushtetues. Vendimin e sipërpërmendur e ka nënshkruar, përveç Kryeministrit, edhe ministri propozues, Ylli Bufi. Kjo gjë vërtetohet me nënshkrimin e tij në kopjen e këtij akti, e cila i është dërguar të gjitha institucioneve, disa muaj përpara se kërkuesi t’i drejtohej kësaj Gjykate.

Nga ana tjetër, përmbajtja e këtij vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare. Ky fakt është i mjaftueshëm për t'i dhënë këtij akti nënligjor fuqinë e tij juridike, ashtu siç parashikohet në nenin 117 të Kushtetutës.

Të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera të kërkuarit.

Nga shqyrtimi në tërësi i Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre", del se me dispozita të tij të veçanta që i përkasin neneve 9, 18, 19/3, 20/4, 21 dhe 23, Këshilli i Ministrave është ngarkuar në mënyrë të shprehur që të rregullojë me akte nënligjore këtë fushë të veprimtarisë ekonomike. Pikërisht mbi këtë bazë dhe jo në mënyrë arbitrare, siç pretendon kërkuari, ai ka nxjerrë vendimin e tij, objekt i kontrollit të kësaj Gjykate.

Nga ana tjetër, kushtet e parashikuara në këtë vendim për tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, vërtet e ngushtojnë në një farë mase sferën e ushtrimit të kësaj veprimtarie, por ato nuk janë veçse kritere, sepse janë të prejardhura ose të diktuar nga kufizimet që i ka vënë asaj vetë ligji.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 11 të Kushtetutës ka vendosur këto kufizime vetëm për arsye të rëndësishme publike, ndërsa Këshilli i Ministrave, brenda kuadrit të këtyre kufizimeve ka përcaktuar kriteret për zhvillimin e kësaj veprimtarie, me burim rreziku të shtuar që paraqet rëndësi të veçantë për ekonominë kombëtare, mjedisin dhe mbrojtjen e vendit.

Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se Vendimi i Këshillit të Ministrave nuk përmban kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe për rrjedhojë nuk ka përmbajtje antikushtetuese sikurse pretendon pala kërkuuese.

Po ashtu, ajo nuk e gjen të bazuar edhe pretendimin lidhur me pasojat që mund të sjellë zbatimi i këtij vendimi, i cili sipas tij do të çojë në monopolizimin e kësaj veprimtarie në dorën e dy ose tre subjekteve më të fuqishëm, duke mënjeluar kështu konkurrencën e lirë dhe duke shkaktuar ngritjen e çmimeve.

Ardhja e këtyre pasojave nuk është evidente. Ato edhe në qoftë se vërtetohen, Këshilli i Ministrave mund t'i eliminojë, duke ndryshuar në çdo kohë, sipas diskrecionit të tij dhe brenda kufijve të ligjit, kriteret që ai ka parashikuar në këtë vendim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a,c dhe 134/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 41 të Ligjit nr. 8373, datë 15.07.1998, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës, si të pabazuar.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 07.12.1999

Nr. 57 i regjistrimit themeltar

Nr. 64 i Vendimit